



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Lutfi Haziri, Kryetar

Adresa: Bulevardi i Pavarësisë p.n., Gjilan, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (Komuna e Gjilanit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Për pagesat në vlerë prej 631,405€ nuk ishin rrespektuar hapat për procedim të pagesave.
- B1 Tek procedura “Punë Publike - projekte të vogla në infrastrukturë” në vlerë 570,000€, operatori ekonomi nuk i kishte plotësuar kërkesat e dosjës së tenderit si dhe Menaxheri i Projektit ishte edhe Kryetari i komisionit për vlerësim të ofertave.
- B2 Dy projekte në vlerë të përbashkët 707,744€ nuk kishin projekt ekzekutiv.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos-respektim i hapave për procedimin e pagesave sipas Rregullave Financiare

Gjetja

Rregulla Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, Neni 22 përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, pastaj lëshohet Urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë

Nga 22 mostrat të testuara si pjesë e testimeve substanciale në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, kemi gjetur se në 17 prej tyre në shumë prej 631,405€ nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është sjellë malli/shërbimi dhe fatura e pastaj është bërë zotimi i mjeteve dhe është lëshuar Urdhërblerja.

Nga zyrtarët përgjegjës, nuk janë dhënë shpjegime për rastet. Kjo ishte si pasojë e mungesës së duhur të kontrollit me rastin e procesimit të pagesave.

Ndikimi

Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave nga ana e Komuës paraqet rrezikun që Komuna të mos jetë në gjendje të paguaj për mallin/shërbimin e pranuar pasi që porosia e dërguar nuk është bërë duke u bazuar në fondet disponibile të Komunës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që bëjnë procedimin e pagesave do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullat Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Ndarje jo e duhur e detyrave në procesin e prokurimit dhe si dhe Shpërblimi me kontratë pa i plotësuar kërkesat administrative të dosjes së tenderëve

Gjetja

Sipas nenit 62.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit, mirëpo në rast të ri-vlerësimit, anëtarët e komisionit të kaluar të vlerësimit mund të shërbejnë si Menaxher të projektit.

Poashtu sipas RRUOPP, neni 41.1: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen, krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Për kontratën "Punë Publike - projekte të vogla në infrastrukturë" vlera e parashikuar e kontratës 570,000€ është vërejtur se:

- Kryetari i komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit ishte caktuar edhe Menaxher projekti për këtë kontratë. Sipas sqarimeve të zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhur, pasi që ishte kohë Pandemie dhe nuk kishte zyrtarë tjerë të cilët e pranonin këtë pozitë.
- Operatori ekonomik fitues nuk kishte ofruar dëshmi se e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit (çekiç pneumatik). Sipas anëtarëve të komisionit të vlerësimit meqënëse Operatori Ekonomik ka ofruar një çekiç, e kanë konsideruar që mjafton për të plotësuar këtë kriter nga dosja e tenderit.

Ndikimi

Ndarja jo e duhur e detyrave, respektivisht angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në vlerësimin e ofertave, por edhe në menaxhimin e projektit është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme dhe rritë rrezikun e konfliktit të interesit.

Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik të cilët mund të mos i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, mund të ndikojë që të njëjtit të mos mund t'i përfundojnë punët siç kërkohet pasi që nuk kanë arritur të dëshmojnë se posedojnë pajisjet e kërkuara sipas specifikave të dosjes së tenderëve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit. Po ashtu të sigurohet se nga operatori ekonomik fitues janë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit

Gjetja

Sipas nenit 28.10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), definohet qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedoj një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të procedurave të kontraktimit të punëve.

Projekti "Punë publike - projekte të vogla në infrastrukturë" vlera e parashikuar e kontratës 570,000€ dhe projekti "Rekonstruimi i rrugëve në Lagjen Dardania" në vlerë prej 137,744€, nuk kishte projekt ekzekutiv të ndërtimit.

Sipas zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhur pasi njëri projekt është për shtrimin e rrugës e cila veç është ekzistuese, ndërsa projekti tjetër ka të bëjë me intervenime sipas nevojës në infrastrukturën publike.

Ndikimi

Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesë ligjore dhe mundëson realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara dhe mund të rezultojë me shpenzime të paparashikuara nga komuna.

Rekomandimi B2 Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve ndërtimore, Departamenti përkatës ka hartuar projektetet dhe pjesën tjetër të dokumentacionit teknik-investigativ në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja C1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të procedohen në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Komuna kishte kryer pagesa nga kategoritë e gabuara ekonomike në vlerë 182,859€, si:

Vlera 172,020€ është paguar për shërbime të varrimit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndërsa sipas natyrës së shpenzimit i takojnë kategorisë së subvencioneve.

Nga kategoria e investimeve kapitale janë bërë dy pagesa në vlerë 10,839€ për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Ato kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e sinjalizimeve horizontale dhe vertikale në qytetin e Gjilanit dhe blerjen e materialeve shpenzuese për shkolla.

Këto kishin ndodhur pasi që planifikimi i shpenzimeve ishte bërë nga kategoritë jo adekuate.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për vitin 2020 është 15,929,937€. Numri i lejuar i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,478 ndërsa numri aktual në fund të vitit ishte 2,396. Gjatë vitit 2020 ishin punësuar 91 të rinj. Në këtë fushëm, ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë prej 39,951€.

Çështja B3 - Pagesa e pagave me koeficient me të ulët së sa në Akt Emërime

Gjetja

Edhe këtë vit, Komuna ka vazhduar me kompensimin e tre shërbyesve civil jo në pajtim me Akt Emërimet.

- Përgjegjësi në sektorin e katalogimit dhe klasifikimit të librit, sipas kontratës duhej të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit në kontratë nga 6 në 7 është bërë më 01.02.2012 por nuk është zbatuar;
- Shefi i Sektorit për Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 9, por sipas listës së pagave ai paguhet me koeficient 7.5. Ndryshimi i koeficientit nga 7.5 në 9 në kontratë është bërë më 01.02.2013 por nuk është zbatuar; dhe
- Përgjegjësi në Sektorin e Fëmijëve dhe të Rinjve, me Akt Emërim duhet të paguhet me koeficient 7, por sipas listës së pagave, paguhet me koeficient 6. Ndryshimi i koeficientit nga 6 në 7 është bërë më 01.02.2012.

Sipas menaxhmentit të komunës kjo ka ndodhur për shkak të gradimit në vitet e mëhershme dhe ndryshimi apo rritja e koeficienteve është bërë pa u siguruar se Komuna kishte mundësi financiare apo duke mos marr parasysh ndikimin financiar për këto pozita

Ndikimi

Pagesa e punonjësve në kundërshtim me akt emërimet / kontratat e punës është shkelje ligjore dhe padrejtësisht dëmton stafin e komunës në kuptimin material. Kjo mund ta ekspozoj komunën ndaj padive gjyqësore që mund shkaktojnë shpenzime shtesë për buxhetin.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet që para se të bëj gradimet e stafit, së pari të siguroj fondet e duhura buxhetore, ndërsa në bashkëpunim me Thesarin të filloj pagesat e pagave të prapambetura sipas kontratave të nënshkruara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe Shërbime Komunale në vitin 2020 ishte 5,380,979€, prej tyre ishin shpenzuar 4,646,152€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerje të materialeve, furnizim për zyre, qira, lëndë djegëse, riparime dhe mirëmbajtje etj. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 704,439 si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë

Çështja B4 - Shpërblimi me kontratë pa i plotësuar kërkesat administrative të dosjes së tenderëve

Gjetja

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) neni 41.1: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen, krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Tek procedura e prokurimit "Sigurimi i Automjeteve të Komunës" kërkesë e dosjes së tenderit ishte që Operatori Ekonomik fitues të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në vlerë minimale jo me pak se 160,000€, në tre vitet e fundit. Ndërsa Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për shumën 111,087€.

Zyrtarët e prokurimit pohojnë se ky ka qenë vetëm një gabim teknik

Ndikimi

Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dosjes së tenderit, mund të ndikojë që të njëjtit të mos mund t'i përfundojnë punët me kohë dhe sipas cilësisë së kërkuar pasi që nuk kanë arritur të dëshmojnë se posedojnë pajisjet e kërkuar sipas specifikave të dosjes së tenderëve.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të tenderëve të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,633,248€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 1,159,160€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pagesa për përfitues individual, subvencione për entitete publike, etj. Kemi testuar nëntë (9) mostra për teste substanciale në vlerë 316,082€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë. Sa i përket të gjeturës në Raportin e Auditimit të vitit 2019 “Dhënia e subvencioneve për përfituesit e njëjtë”, Komuna në fund të vitit 2020 kishte ndryshuar Rregulloren Komunale ku lejon që përfituesit e njëjtë të përfitojnë subvencione më shumë se një herë.

Çështja B5 - Mos përgatitja planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja Rregullorja e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik Të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-tëmë së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.

Komuna e kishte përgatitur Planin Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dhe e kishte dorëzuar në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mirëpo ky plan nuk përfshinte subvencionimet e OJQ-ve që do të bëheshin në vitin 2020, por përmban vetëm subvencionimet e OJQ-ve në fushën e Kulturës që do të jepen gjatë vitit 2021.

Duket se komuna me vonesë e ka marrë parasysh pjesërishtë rekomandimin e vitit të kaluar. Megjithatë, nga zyrtarët komunal nuk ka ndonjë përgjigje konkrete.

Ndikimi Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave së cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete, çka mund të dëmtoj transparencën.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,533,320€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 5,739,889€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e objekteve administrativo afariste, mirëmbajtje investive, blerjen e automjeteve etj. Kemi testuar 31 mostra për teste substanciale në vlerë 1,676,335€, dhe pesë (5) mostra për pajtueshmëri.

Çështja B6 - Tejkallim i sasive të kontraktuara

Gjetja Sipas RRUOP te neni 56.10 përcaktohet se nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikativë ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote edhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Për kontratën kornizë “Mirëmbajtja teknike e objekteve në të gjitha njësitë kërkuese në Komunën e Gjilanit”, në vlerë prej 711,089€, Komuna për 12 pozicione ka tejkalluar sasinë totale të këtyre pozicionëve të kontratës kornizë. Në total për këto pozicione për tre vite maksimumi i pagesave do duhej të ishte 40,095€. Për këto pozicione kishte tejkallime edhe në vitin 2019, ndërsa në vitin 2020 për këto pozicioni ishin paguar edhe 125,371€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrollit të kushteve të përcaktuara me kontratë.

Ndikimi Vlerësimi jo adekuat i nevojave shpie në përsëritjen e procedurave tenderuese, duke shkaktuar shpenzime shtesë të paarsyeshme të parasë publike. Njëkohësisht tejkallimi i vlerave indikativë trevjeçare, ndikon në rritjen e obligimeve të paplanifikuara gjatë viteve.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkallim të sasive të kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Inicimi i projekteve pa zotim paraprak të fondeve

Gjetja Sipas Rregullës financiare 01/2013 MF-Për shpenzimin e parasë publike Neni 12, pika 2, kërkohet që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore (OB) i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financiar në Kosovë (SIMFK) në përputhje me rregullat.

Kontrata për projektin "Rekonstruimi i rrugëve në lagjen Dardania" vlera e kontratës ishte 134,744€ ndërsa vlera e zotimit ishte 10,000€.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme e rrit rrezikun e vonesave në zbatim të kontratave dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Vonesa në procesin e vlerësimit të procedurave të prokurimit

Gjetja Neni 41.2 "Udhëzuesit operativ për prokurimin publik", përcakton: Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Vlerësimi duhet të filloj jo më vonë se 5 ditë pas hapjes së ofertave.

Gjatë testimit të procesit të vlerësimit të ofertave për projektin "Renvovimi dhe funksionalizimi i objekteve shkollore në kopshtet për fëmijë në fshatin Zhegër" në vlerë prej 81,508 euro, kishte vonesë në vlerësimin e ofertave për 30 ditë.

Lidhur me vonesat nuk ka ndonjë shpjegim nga zyrtarët komunal.

Ndikimi Vonesat në vlerësimin e ofertave, mund të ndikojnë që fillimi dhe kryerja e punëve për të cilat është zhvilluar aktiviteti i prokurimit të mos përfundojnë me kohë apo edhe të shtyhen për vitin tjetër.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të kryhet brenda afateve kohore të parapara me rregulloret e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale 218,316,634€, pasurive jokapitale është 1,429,627€, si dhe e stoqeve 197,739€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,949,749Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 218,316,634€, pasurive jokapitale është 1,429,627€, si dhe e stoqeve 197,739€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,949,749€ si dhe kemi bërë teste të pajtueshmërisë.

Çështja C3 - Mbivlerësimi/Nënvlerësimi i pasurisë kapitale

Gjetja

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Nga testimi kemi gjetur se komuna ka bërë mbivlerësim/nënvlerësim te pasurive kapitale në rastet si në vijim:

Gjashtë pagesa në vlerë prej 92,940€ të cilat ishin edhe në Raportin e Auditimit (RA) të vitit 2019 ende nuk i ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë. Këto pagesa i takojnë pasurisë kapitale.

Pasuritë në vlerë 6,360€ ishin regjistruar tek aplikacioni Excel, si pasuri nën 1,000€ ndërsa kjo pasuri i takon pasurive kapitale, edhe këto ishin të gjetura në RA 2019.

Pasuria në vlerë prej 4,814€ ishte regjistruar si Investim në vijim, ndërsa ajo do duhej të regjistrohej si pasuri në përdorim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve komunal.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurisë dhe regjistrimi i gabuar ndikon në mbivlerësim/nënvlerësimin e regjistrat të pasurive, dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PFV të mos jenë të sakta.

Rekomandimi C3

Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mos përdorimi i sistemit e-pasuria dhe mungesa e rregulloreve të brendshme për pasuri

Gjetja

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 pasuria nën 1,000€, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.
Sipas nenit 4 të rregullores 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtën dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare

Vlera totale e pasurive jo kapitale nën vlerën 1,000€ në PFV ishte 1,429,627€. Komuna nuk përdorë programin E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€. Komuna aplikon programin Excel për evidentimin e kësaj pasurie, dhe në këtë program nuk regjistrohen pasuritë sipas vlerës individuale të artikullit, por sipas shumës së transaksionit të ndodhur. Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës.

Komuna nuk ka dhënë shpjegime lidhur me mospërdorimin e e-pasurisë, Prandaj, konsiderojmë se kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve komunal.

Ndikimi

Mos përdorimi i programit E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë mundëson manipulimin me të dhëna e deri te keqpërdorimi i saj dhe rrjedhimisht ndikon në mos prezantim të drejtë të vlerës së pasurisë në PFV. Mos aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme mund të ndikojë që pasuria të keqpërdoret apo të humbet.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu, komuna duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth menaxhimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Të arkëtueshmet

Komuna e Gjilanit në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 11,997,965€. Kjo shumë përbëhet nga tatimi në pronë 9,906,693€, nga licencat e biznesit 1,751,033€, nga dhënia me qira e pronës komunale 301,628€, nga partneriteti publiko privat 33,404€ si dhe nga inkubatori i bizneseve 5,207€.

Çështja A2 - Menaxhimi i Llogarive të arketueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtyllë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk ka krijuar mekanizma efikas për mbledhjen e të arkëtueshmeve. Për faktin se të arkëtueshmet janë rritur nga viti në vit, një numër i madh i debitorëve të tatimit në pronë, dhe të atyre të marrjes me qira të pronës komunale, nuk kanë paguar borxhet e tyre. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshmeve janë rritur për 1,205,562€.

Komuna e Gjilanit nuk kishte marrë masa konkrete për arkëtimin e llogarive të arketueshme për shkak të Pandemisë.

Ndikimi

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezultojnë me fonde të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikojnë edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.8 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 11,012,843€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021. Vlera kryesore e tyre u përket detyrimeve për Investime kapitale 9,765,836€.

Çështja B9 - Mungesa e librit të faturave dhe vonesa në pagimin e tyre

Gjetja Sipas nenit 24. Pika 1.3 të Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcaktohet se fatura duhet të protokollohet/regjistrohet dhe të evidentohet në Librin e Faturave. Ndërsa Neni 37.1 përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Komuna e Gjilanit nuk ka Libër të Faturave ku bëhet protokollimi i faturave të pranuar. Zyrtarët Komunal përdorin një softuer për protokollimin e faturave, mirëpo nuk ka ndonjë mekanizëm që verifikon saktësinë e tij. Poashtu në mostrat e testuara nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi se faturat e pranuar janë evidentuar (protokolluar).

Shtatë fatura në vlerë prej 26,129€, ishin paguar pas skadimit të afatit prej 30 ditë. Arsye e vonesës sipas zyrtarëve komunal për mos pagimin e faturave në afat ishte mungesa e buxhetit.

Ndikimi Mos protokollimi i faturave të pranuar paraqet rrezik që faturat të paguhen më shumë se një herë dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë Komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të fillojë të bëjë protokollimin/regjistrimin e të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	27,509,087	29,477,491	27,361,357	25,549,636	24,353,251
Grante Qeveritare - Buxheti	23,109,691	23,351,056	23,241,424	20,349,084	19,693,440
Financimi përmes huamarrjes	0	276,356	239,711	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	749,246	741,694	1,042,842	956,796
Të hyrat vetanake	4,399,396	4,399,396	2,608,996	3,880,386	3,213,264
Donacionet vendore	0	28,568	22,237	55,603	50,532
Donacionet e jashtme	0	672,869	507,294	221,721	439,219

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,968,404€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak si dhe donacioneve.

Në vitin 2020 Komuna e Gjilanit ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar ose 27,361,357€, më një ulje prej 1% krahasuar me 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	27,509,087	29,477,491	27,361,357	25,549,636	24,353,251
Pagat dhe mëditjet	15,609,297	15,929,937	15,816,156	14,958,556	14,883,094
Mallrat dhe shërbimet	3,860,000	4,752,091	4,189,744	3,722,837	3,205,411
Komunalitë	671,500	628,887	456,408	515,226	684,100
Subvencionet dhe transferet	608,936	1,633,248	1,159,159	775,550	778,398
Investimet Kapitale	5,064,157	6,533,327	5,739,889	5,577,469	4,802,248
Rezervat	1,695,197	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 320,640€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga rishikimi i ligjit të Buxhetit në vlerë prej 195,620€, vlera prej 90,020€ nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës, si dhe 35,000€ janë rritje nga donacionet.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 892,090€, nga kjo vlerë: 71,290€ kishte rritje nga rishikimi i Ligjit të Buxhetit, 306,040€, me Vendim të Kuvendit Komunal për transferimin e mjeteve nga rezerva në kategori të caktuara, 90,000€ nga Vendimet e Qeverisë, 42,120€ buxheti ishte rritur nga marrëveshja mes Ministrinë e Arsimit dhe Komunës së Gjilanit për Grant Shkollor, 240,000€ rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2019, si dhe 142,640€ ishin nga donacionet

Buxheti final për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 42,613€ nga Vendimet e Qeverisë.


Buxheti final për subvencione ishte rritur për 1,024,312€, nga kjo vlerë: 120,000€ rritja me Vendim të Kuvendit Komunal për transferimin e mjeteve nga rezerva në kategori të caktuara, 275,000€ nga Vendimet e Qeverisë, 188,246€ nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2019, dhe 441,066 ishin rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,474,170€.

Kjo rritje vjen si rezultat i Vendimit të Kuvendit Komunal për transferimin e mjeteve nga rezerva në kategori të caktuara 1,002,250€. Rritja për 63,190€ ishte nga marrëveshja mes Ministrinë e Arsimit dhe Komunës së Gjilanit për Grant Shkollor. Rritja prej 321,000€ ishte me Vendim të Kuvendit Komunal për transferimin e mjeteve nga të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2019, dhe rritja prej 87,730€ ishin nga grantet e donatorëve.

Mjetet e shpenzuara për Menaxhimin e Emergjencës nga Covid-19 ishin 760,389€, ndërsa ato për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin në vlerë prej 344,147€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	4,399,396	4,399,396	2,758,090	3,765,119	3,360,094
Të hyrat tatimore	2,035,561	2,035,561	1,340,924	1,651,323	1,412,106
Të hyrat jo tatimore	2,363,835	2,363,835	1,417,166	2,113,795	1,947,988

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Gjilanit ka rezultuar në 17 rekomandime kryesore. Komuna e Gjilanit kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020 pesë (5) rekomandime janë zbatuar, tre (3) janë në proces të zbatimit, nëntë (9) nuk janë zbatuar ende.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit.	Për një kontratë, anëtari i komisionit të vlerësimit ishte emëruar edhe Menaxher i asaj kontrate.	Nuk është adresuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.	Për dy kontrata që janë të karakterit të punëve nuk kishte projekte detaje edhe këtë vit.	Nuk është adresuar

3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Gjendja në RA të vitit 2020 është e njëjtë, ndërsa në vitin 2021 Komuna kishte marrë masa dhe shpenzimet për Shërbime të varrimit tani pagesat bëhen nga kategoria e Subvencioneve.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet që prona e paluajtshme e komunës të shfrytëzohet në mënyrë efektive duke pasur parasysh respektimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Nuk kemi të gjetura të kësaj natyre për këtë vit të auditimit.	I zbatuar
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që të planifikojë buxhet të mjaftueshëm dhe në bashkëpunim me Thesarin të filloj pagesat e pagave sipas kontratave të nënshkruara.	Nuk kishte veprime të ndërmara nga Komuna dhe gjendja është e njëjtë si në RA të vitit 2019.	Nuk është adresuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.	Komuna ka bërë një përparim në vlerësimin e tenderëve ku këtë vit kemi vetëm një të gjetur sa i përket vlerësimit të dosjeve të tenderëve nga kategoria e Investimeve Kapitale.	Nuk është adresuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.	Nuk ishte zbatuar ky rekomandim gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se subvencionet do të jepen në pajtim me Rregulloren e Komunës, ku një fermer nuk mund të jetë përfitues më shumë se një herë brenda vitit. Përndryshe të shqyrtohet mundësia e ndryshim-plotësimit të rregullores për dhënie të subvencioneve.	Komuna e kishte ndryshuar Rregulloren, ku lejon që një përfitues ka të drejtë të përfitimit të subvencioneve më shumë se një herë.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo kontratë të nënshkruar të emërohet menaxheri i projektit, pavarësisht faktit se Komuna ka organ mbikëqyrës.	Komuna për të gjitha kontratat të cilat kanë qenë pjesë e testeve tona kishte emëruar Menaxher të tyre.	I zbatuar

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale të jenë të përcaktuara saktë nevojat që do të realizohen përmes kontratave kornizë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës mbajnë shënime adekuate për nivelin e furnizimit të çdo artikulli sipas kontratës kornizë.	Ne kemi testuar për kontratën e njëjtë se a janë marrë masa që të mos tejkalohën artikujt nëpër pozicione por gjendja është e njëjtë si në RA të vitit të kaluar.	Nuk është adresuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.	Edhe këtë vit për një projekt nuk ishte zotuar shuma e plotë.	Nuk është adresuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë, vlerësimi të kryhet brenda afateve kohore të parapara, dhe se të gjitha njoftimet dhe dokumentet tjera të kërkuara sipas RRUOPP do të publikohen në kohë.	Këtë vit kishim vetëm një vonesë në vlerësimin e ofertave.	Pjesërisht i zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë. Pasuria e blerë për ndërmarrjen Tregu të largohet nga regjistri i pasurisë së komunës.	Ndërmarrja Tregu është fshirë nga regjistri i pasurisë së Komunës, poashtu edhe pagesat e pranuar nga palet e treta ishin regjistruar në regjistrin e pasurive nën 1,000euro, ndërsa për dy rastet e tjera gjendja është e njëjtë.	Pjesërisht i zbatuar
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.	Gjendja është e njëjtë si në Raportin e Auditimit të vitit të kaluar.	Nuk është adresuar
15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet protokollimi/regjistrimi i të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.	Gjendja është e njëjtë si në Raportin e Auditimit të vitit të kaluar.	Nuk është adresuar
16.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se Avokati i Komunës informon Zyrën e Financave për obligimet që dalin nga vendimet e gjykatës, në mënyrë që raportimi i obligimeve të papaguara të jetë prezantuar drejtë në pasqyra financiare.	Gjatë këtij viti të gjitha detyrimet ishin prezentuar saktë.	I zbatuar

17.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se prezantimi i detyrimeve bëhet saktë sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin e financave publike.	Gjatë këtij viti të gjitha detyrimet ishin prezentuar saktë.	I zbatuar
-----	-----------------------	---	--	-----------

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit. Po ashtu të sigurohet se nga operatori ekonomik fitues janë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve ndërtimore, Departamenti përkatës ka hartuar projektetet dhe pjesën tjetër të dokumentacionit teknik-investig në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që bëjnë procedimin e pagesave do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullat Financiare për shpenzimin e parave publike.
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që para se të bëjë gradimet e stafit, së pari të siguroj fondet e duhura buxhetore, ndërsa në bashkëpunim me Thesarin të filloj pagesat e pagave të prapambetura sipas kontratave të nënshkuara.
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të tenderëve të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkallim të sasive të kontraktuara.
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të kryhet brenda afateve kohore të parapara me rregulloret e prokurimit.
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë.
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu, komuna duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth menaxhimit të pasurisë.
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të filloj të bëjë protokollimin/regjistrimin e të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Pleurat Isufi, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PROJECTI/PROJEKTI: - 9.06.2021 KATEGORIA/ KATEGORIJA/ KATEGORIJA:			
Niveli/Level Org./Unit	Klasifik./Classif. Klasif./Kod Class./Code	Nr. Prot./Br. Prot. Prot. No.	Nr./faqeve/Br. Stranica No. Pages
04	47	808	1

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E GJILANIT 02 09.06.2021	400
--	-----

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
 OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjilanit, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Lutfi Haziri
 Kryetar i Komunës së Gjilanit
 Data : 09.06.2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.